L I G J
Nr.8775, datë 23.4.2001

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS NR.131, DATË 6.6.1970 TË ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE TË PUNËS "CAKTIMI I PAGËS MINIMALE""

Në mbështetje të neneve 47, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K UV E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Neni 1

Ratifikohet "Konventa nr.131, datë 6.6.1970 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës "Caktimi i pagës minimale"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2998, datë 4.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani

KONVENTA NR. 131

Konventa lidhur me Caktimin e Pagës Minimale, me Referencë të veçantë për Vendet në Zhvillim

Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Ndërkombëtare të Punës,

E thirrur në Gjenevë nga Këshilli Drejtues i Zyrës Nderkombëtare të Punës dhe e mbledhur në sesionin e saj të pesëdhjetë e katër, më 3 Qershor 1970, dhe

Duke vërejtur kushtet e Konventës, 1928, Metodat e Caktimit te Pagës Minimale dhe të Konventës 1951, Shpërblimi i Barabartë, të cilat janë ratifikuar nga shumica e Anëtarëve, si dhe të Konventës, 1951, Metodat e Caktimit të Pagës Minimale (Bujqësi), dhe

Duke marrë në konsideratë që kjo Konventë ka luajtur një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e grupeve të disfavorizuara të rrogëmarrësve, dhe

Duke marrë në konsideratë se ka ardhur koha që të miratohet një instrument tjetër që të plotësojë këtë Konventë dhe të sigurojë mbrojtjen e pagëmarrësve kundrejt pagave padrejtësisht të ulta, që, ndërsa për një zbatim të gjerë, i kushton vëmëndje të veçantë nevojave të vendeve në zhvillim, dhe

Pasi ka vendosur mbi miratimin e disa propozimeve, lidhur me metodat e caktimit të pagës minimale dhe çështjet që lidhen me të, me referencë të veçantë për vendet në zhvillim, e cila është pika e pestë e axhendës së sesionit dhe

Pasi ka vendosur që këto propozime të marrin formën e një Konvente ndërkombëtare miraton në këtë ditë të njëzetë e dytë të Qershorit të vitit njëmijë e nëntëqintë e shtatëdhjetë, Konventën e mëposhtme, e cila mund të quhet Konventa për Caktimin e Pagës Minimale, 1970:

Neni 1

1.Çdo anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës, i cili ratifikon këtë Konventë, angazhohet të krijojë një sistem të pagës minimale, i cili të mbrojë të gjitha grupet e rrogëmarrësve, kushtet e punësimit të të cilëve janë të tilla që kërkojnë mbrojtje të përshtatëshme.

2. Autoriteti kompetent në secilin vend duhet, në marrëveshje ose pas konsultimit të plotë me organizatat përfaqësuese të interesuara të punëtorëve dhe të punëmarrësve, ku këto organizata ekzistojnë, të përcaktojë grupet e rrogëmarrësve që duhen mbrojtur.

3. Çdo Anëtar, i cili ratifikon këtë Konventë, duhet të listojë, në raportin e parë mbi zbatimin e Konventës, që paraqitet sipas nenit 22 të Kushtetutës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës, çdo grup të pagëmarrësve të cilët mund të mos jenë mbrojtur sipas këtij Neni, duke dhënë arsyet e mosmbrojtjes së tyre, dhe të deklarojë në raportet e ardhëshme pozicionin e legjislacionit dhe praktikës në lidhje me grupet e pambrojtura, dhe masën në të cilën i është dhënë fuqi ose është propozuar për t'i dhënë fuqi Konventës lidhur me këto grupe.

Neni 2

1. Pagat minimale duhet të kenë fuqinë e ligjit dhe nuk duhet të jenë objekt i uljeve dhe personi ose personat që nuk zbatojnë kuotat e caktuara duhet t'u nënshtrohen sanskioneve penale ose sanskioneve të tjera.

2. Me rezervën e dispozitës së paragrafit 1 të këtij Neni, liria e negociatave kolektive duhet të respektohet plotësisht.

Neni 3

Elementët që duhen marrë në konsideratë për përcaktimin e nivelit të pagave minimale duhet, për aq sa është e mundëshme dhe e përshtatëshme në lidhje me praktikën dhe kushtet e vendit, të përfshijnë:

a) nevojat e punëtorëve dhe të familjeve të tyre, duke marrë në konsideratë nivelin e përgjithshëm të pagave në vend, koston e jetesës, përfitimet nga mbrojtja shoqërore dhe standartet relative të jetesës të grupeve të tjera shoqërore;

b) faktorët ekonomikë, duke përfshirë kërkesat e zhvillimit ekonomik, nivelet e prodhimit, si dhe dëshirën për arritjen dhe ruajtjen e një niveli të lartë punësimi.

Neni 4

1. Çdo Anëtar që ratifikon këtë Konventë duhet të krijojë dhe/ose të mbajë metoda, në përputhje me kushtet dhe kërkesat e vendit, me anën e të cilave pagat minimale për grupet e rrogëmarrësve të mbrojtur sipas Nenit 1, mund të caktohen dhe përmirësohen herë pas here.

2. Në përputhje me krijimin, funksionimin dhe përmirësimin e këtyre metodave, duhet të nxiren dispozita për konsultimin me organizatat përfaqësuese të punëtorëve dhe punëmarrësve të interesuar, ose në mungesë të këtyre organizatave, me përfaqësuesit e punëtorëve dhe punëdhënësve të interesuar.

3. Në çdo rast që është i përshtatshëm për natyrën e metodave të caktimit të pagës minimale, duhet të nxirren gjithashtu dispozita për pjesëmarrjen direkt në zbatimin e tyre të:

a) përfaqësuesve të organizatave të interesuara të punëtorëve dhe të punëdhënësve, ose në mungesë të tyre, të përfaqësuesve të punëtorëve dhe punëdhënësve të interesuar, mbi bazën e brazisë;

b) personave kompetente për të përfaqësuar interesat e përgjithshme të vendit dhe të caktuar pas konsultimit me organizatat përfaqësuese të punëtorëve dhe punëdhënësve të interesuar, ku këto organizata ekzistojnë dhe ky konsultim në përputhje me legjislacionin ose praktikën e vendit.

Neni 5

Për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitave që lidhen me pagën minimale, duhet të merren masat e duhura, si inspektimi adekuat i përforcuar me masa të tjera të nevojshme.

Neni 6

Kjo Konventë nuk do të prezumohet që ndryshon çdo Konventë në fuqi.

Neni 7

Ratifikimi zyrtar i kësaj Konvente duhet t'i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës.

Neni 8

1. Kjo Konventë është e detyrueshme vetëm për ata Anëtarë të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, të cilët e kanë regjistruar ratifikimin e saj te Drejtori i Përgjithshëm.

2. Ajo hyn në fuqi 12 muaj pas datës së regjistrimit të ratifikimit të saj nga dy Anëtarë tek Drejtori i Përgjithshëm.

3. Pas kësaj Konvente do të hyjë në fuqi për çdo Anëtar 12 muaj pas datës në të cilën është regjistruar ratifikimi i saj.

Neni 9

1. Anëtari që ka ratifikuar këtë Konventë mund ta denoncojë atë pas kalimit të dhjetë vjetëve nga dita e hyrjes së saj në fuqi për herë të parë me anën e një akti që i komunikohet për regjistrim Drejtorit të Përgjithshëm të Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Ky denoncim do të hyjë në fuqi pas një viti nga dita e regjistrimit të tij.

2. Çdo Anëtar i cili ka ratifikuar këtë Konventë dhe i cili nuk e ushtron të drejtën e denoncimit të parashikuar në këtë Nen, brenda një viti pas kalimit të afatit 10-vjeçar të përmendur në paragrafin e mësipërm, do të jetë i detyruar për një afat tjetër 10 vjeçar, dhe pas këtij afati mund të denoncojë këtë Konventë pas kalimit të çdo afati 10 vjeçar, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Nen.

Neni 10

1. Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet të njoftojë të gjithë Anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Punës për të gjitha ratifikimet dhe denoncimet që i komunikohen atij nga Anëtarët e Organizatës.

2. Kur njofton Anëtarët e Organizatës për regjistrimin e ratifikimit të dytë që i komunikohet atij, Drejtori i Përgjithshëm duhet t'ju bëjë të ditur Anëtarëve të Organizatës datën në të cilën Konventa hyn në fuqi.

Neni 11

Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim sipas Nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të gjitha veçoritë e ratifkimeve dhe akteve të denoncimeve të regjistruara nga ai, në përputhje me dispozitat e Nenit të mësipërm.

Neni 12

Këshilli Drejtues i Organizatës Ndërkombëtare të Punës duhet t'i paraqesë, në një kohë që e gjykon të nevojshme, Konferencës së Përgjithshme një raport për zbatimin e kësaj Konvente dhe duhet të shqyrtojë nëse mund të vendoset në axhendën e Konferencës çështja e ndryshimit të pjesshëm apo të plotë të saj.

Neni 13

1. Kur Konferenca miraton një Konventë të re, duke ndryshuar këtë Konventë pjesërisht apo tërësisht, atëherë përveç kur Konventa e re parashikon ndryshe:

a) Ratifikimi nga një Anëtar i një Konvente të re që ndryshon këtë Konventë sjell denoncimin e menjëhershëm të kësaj të fundit, pavarësisht nga dispozitat e Nenit 9 më sipër, nëse dhe kur Konventa e re hyn në fuqi.

b) Nga data kur Konventa e re që ndryshon këtë Konventë hyn në fuqi, kjo e fundit pushon së qëni e hapur për ratifikim nga Anëtarët.

2. Kjo Konventë do të mbetet, në fuqi në çdo rast, në formën dhe përmbajtjen e saj aktuale për ata Anëtarë të cilët e kanë ratifikuar atë, por nuk kanë ratifikuar Konventën që e ndryshon atë.

Neni 14

Tekstet frengjisht dhe anglisht të kësaj Konvente kanë fuqi të barabartë.